



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 13.03.2017

Ref.: 159/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit Riinvest për njohje të akreditimit të programeve të studimit:

- BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Ndërmarrësi, 360 CATS, 180 ECTS;
- BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Marketing, 360 CATS, 180 ECTS;
- BA (Hons) Biznes dhe Menaxhim i Resurseve Humane, 360 CATS, 180 ECTS;
- MBA Master në Administrim Biznesi (Gjeneral), 180 CATS, 120 ECTS;
- MBA Master në Administrim Biznesi (Financa), 180 CATS, 120 ECTS.

të Universitetit Staffordshire të ofruara në Kolegjin Riinvest në bazë të marrëveshjes së Franshizës për periudhën 4 vjeçare (Kohëzgjatja e marrëveshjes së franshizës është deri më 31 Korrik 2021).

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në kërkesën e BPrAL Kolegji Riinvest të datës 06.04.2016 për njohje të akreditimit, marrëveshjes në mes Universitetit Staffordshire dhe BPrAL Kolegji Riinvest të datë 26.01.2016, neni 3, pika 1.16 e Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), KSHC në mbledhjen e mbajtur më 22.02.2017 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Riinvest"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

